



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS KOSOVO DOCTORS CHAMBER LEKARSKA KOMORA KOSOVA	
Nr. Prot.:	113/2019
Uniti:	ZK
Jedrinca:	
Nr. i faqevë:	
Top. of pages:	-02-
Nr. shprehës:	
Data:	18.01.2019
Datumi:	
Prishtinë	

ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

NR. REF. 113/2018

NGA: Kryetari i Odës së Mjekëve të Kosovës – Dr. Pleurat Sejdiu, Mr.sci

LËNDA: Qarkore njoftuese lidhur me pushimin e statusit së anëtarësimit dhe përfaqësimit të psikologëve klinik në OMK, nga Këshilli Drejtues i OMK-së

Datë: 10 janar 2019

Të nderuar,

Ndonëse që nga themelimi i Odës së Mjekëve të Kosovës (OMK), në draftin e miratuar të Statutit themelues, sipas Nenit 21, paragrafit 10, Shoqata e Psikologëve Klinik ishte paraparë që të përfaqësohet pranë OMK-së me 7 të deleguar pranë Kuvendit të OMK-së deri në formimin e Odave të Profesionistëve të Tjerë Shëndetësor. Kjo dispozitë, ishte miratuar në kohën kur asnjë nga odat e profesionistëve të tjerë shëndetësor nuk ishte themeluar dhe se OMK-ja ishte oda e parë e profesionistëve shëndetësor që ishte themeluar sipas Ligjit Nr. 04/L-150 për Odat e Profesionistëve Shëndetësor. Rrjedhimisht, asnjë arsye faktike nuk ekziston që Shoqata e Psikologëve Klinik të jetë e përfaqësuar në organet e OMK-së. Madje përfaqësimi i tillë në organet e odës si dhe anëtarësimi i psikologëve klinik është i kundërligjshëm sipas përshkrimit ligjor në Nenin 8 lidhur me Nenin 2 me paragrafin 2 të Ligjit Nr. 04/L-150 për Odat e Profesionistëve Shëndetësor, duke pasur parasysh se psikologët klinik nuk kanë thirrjen e mjekut (doktor) qoftë i përgjithshëm apo specialist i lëmisë mjekësore.

Për arsye të tilla, me qëllim të mënjanim të kundërligjshmërisë, e cila në mënyrë të drejtpërdrejt e dëmton edhe përfaqësimin e mjekëve në organet amë të OMK-së, në mbledhjen e thirrur për 17 janar 2019 të Kuvendit të OMK-së, do të shqyrtohet krahas propozim-amendamenteve të tjera, edhe ai në lidhje me shlyerjen e dispozitës e cila përfshinë përfaqësimin e Shoqatës së Psikologëve Klinik pranë OMK-së.

Me pushimin e përfaqësimit, do të pushojë edhe statusi i anëtarësimit të psikologëve klinik pranë OMK-së. Ndërsa sa i përket licencave të lëshuara nga oragni kompetent i OMK-së kanë vlefshmërinë sipas kohëzgjatjes së aprovuar, deri në skadimin e të njëjtave.

Ndërkaq, për sa i përket mbikëqyrjes etike dhe profesionale, pas miratimit të propozim-amendamenteve statutore, mbikëqyrja e tillë do të kalojë pranë odës në të cilën do të jenë të anëtarësuar psikologët klinik, qoftë në nivel të shoqatës apo edhe në nivel personal.

Me respekt,

KRYETARI I OMK-SË

NR. I REF. 113 /2019 dt. 18.01.2019

Prishtinë, 10 janar 2019

Kryetari i OMK-së
Dr. Pleurat Sejdiu, Mr.sci

